

VENDIM
Nr. 24, datë 18.2.2013

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES PËR HECET “LURA 1”, “LURA 2” DHE
“LURA 3” TË SHOQËRISË “ERDAT LURA” SHPK SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 9, pikat 1 dhe 2 germa “a” të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.2.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Erdat Lura” sh.p.k. për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Lura 1”, “Lura 2” dhe “Lura 3”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave” si më poshtë:

- Neni 7 pika 1 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7 pika 2 germat “a”, “b”, “c”, “d”

Është plotësuar tërësisht.

- Neni 7 pika 4 germat “a”, “b”, “c”

Është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Erdat Lura” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Lura 1”, “Lura 2” dhe “Lura 3”, si burime të rinovueshme energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadan